



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Data:	<i>Zyrt. 04 / 15 / dt.15/01/2024</i>
Për:	<i>Zyrës së Informimit në Kuvendin Komunal, Zyrës së pranimi dhe Arkivës pranë KK-së, SIA-së, Radio Gjakovës</i>
Kopje:	<i>Shkolla e Mesme e Lartë Teknike “ Nexhmedin Nixha” në Gjakovë, Arkivë</i>
Nga:	<i>Drejtor i Drejtorisë për Arsim z. Eranda Baçi</i>
Përmes:	<i>Drejtorisë Komunale të Arsimit</i>
Lënda:	<i>Konkurs për mësimin AAPRr – Afati i Janarit/2024</i>



Në bazë të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur në Republikën e Kosovës nr.04/L-143 neni 11, 12, i dt. 13 Dhjetor 2012, Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës nr.03/L-068 neni 5 shkronja b i dt.21 Maj 2008, Rregullore (MASHT) nr.01/2017 për Planifikimin dhe Shpenzimin e të Hyrave Vetanake të Realizuara nga Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit për të Rritur (IAAPRr), Rekomandimit nga MASHT Referencë Nr.3/95 i dt. 06/03/2015, Kërkesës së shkollës nr.prot.1467 i dt.11.01.2024 SHMLT “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë, Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjakovë, shpall :

K O N K U R S

Për regjistrimin e vijuesve (të rriturve) në Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur (AARr) në shkollën „Nexhmedin Nixha” në Gjakovë, për klasët e X-ta, XI-ta dhe XII-ta :

Drejtimi : **Elektroteknikë** me profilet përkatëse:

- Energjetikë..... 32 vijues
- Informatikë 32 vijues
- Instalues elektrik 32 vijues

Drejtimi : **Makineri** me profilet përkatëse:

- Operator prodhimi 32 vijues
- Transport rrugor 32 vijues
- Automekanikë32 vijues

Drejtimi : **Ndërtimtari** me profilet përkatëse :

- Arkitekturë 32 vijues
- Ndërtimtari 32 vijues

Drejtimi : **Tekstilit** me profilin përkatës :

- Rrobaqepës..... 32 vijues

Drejtimi : **Artit Pamor** me profilin përkatës :

- Dizajni i tekstilit dhe veshjeve..... 32 vijues

REGJISTRIMI I VIJUESVE PËR PROGRAMIN nga Institucionet e Arsimit dhe Aftësimi Profesional dhe për të Rritur (IAAPRr), bëhet sipas procedurave të njëjta të regjistrimit për nxënësit e rregullt.

Të drejtë regjistrimi kanë të gjithë të interesuarit, të cilët kanë kaluar moshën për të qenë nxënës të rregullt.

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

1. Dëftesa e klasëve të kryera paraprake
2. Çertifikata e lindjes
3. Pagesa.

Shkollimi në nivelin e Arsimit të Mesëm të Lartë është me pagesë.

Participimi bëhet në bazë të Rregullores nr. 01/2017 të MASHT-it dhe rregullores për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa nga shërbimet Komunale neni 12 nr.12.10.

Pagesa e vijuesve për vijimin dhe përfundimin e (IAAPRr) në shkollat e mesme të larta profesionale do të jetë:

1. Për regjistrim të vitit për një klasë100.00€
2. Praktika profesionale.....50.00€
3. Provimi diferencial10.00€
4. Diploma e përfundimit të shkollimit.....50.00€

Vijuesit të cilët ndërrojnë profilin, do t`u nënshtrohen provimeve diferenciale, bazuar në Rregullores 01/2017 të MASHT-it.Kandidatët të cilët ndërrojnë drejtimin, janë të obliguar që paraprakisht ti nënshtrohen provimeve diferenciale. Dhënja e provimeve diferenciale bëhet në afat të veçantë nga afati për dhënjen e provimeve të klasës për vitin vijues.Dëftesat dhe diplomat që merrën në programin Arsimit dhe Aftësimi për të Rritur janë të barasvlefshme me diplomat e arsimit formal. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.
Dokumentet dorëzohen në SHMLT „Nexhmedin Nixha” Gjakovë .

Respekt!